

Winter 2-2020

Procedurat Për Lidhjen E Martesës

Loreta Bulukraqi

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Law Commons](#)

Recommended Citation

Bulukraqi, Loreta, "Procedurat Për Lidhjen E Martesës" (2020). *Theses and Dissertations*. 1956.
<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/1956>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Koleji UBT
Fakulteti Juridik

PROCEDURAT PËR LIDHJEN E MARTESËS

Shkalla Baçelor

Loreta Bulukraqi

Shkurt, 2020



Fakulteti Juridik

PUNIM DIPLOME

Loreta Bulukraqi

PROCEDURAT PËR LIDHJEN E MARTESËS

Mentori: Prof. Dr. Egzona Osmanaj

Prishtinë, 2020

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Në këtë punim trajtohen dhe analizohen kushtet dhe procedura për lidhjen e martesës në këndvështrimin e të drejtës pozitive në Kosovë. Qëllimi kryesor i këtij punimi është shqyrtimi dhe analizimi i kushteve ligjore dhe procedurës për lidhjen e martesës sipas legjislacionit pozitiv në Kosovë. Përkatësisht, punimi ofron informacione të rëndësishme në lidhje me kushtet për lidhjen dhe vlefshmërinë e martesës, pengesat dhe ndalesat martesore si dhe për karakteristikat dhe rrjedhën e zhvillimit të procedurës për lidhjen e martesës. Për realizimin e qëllimit të tij punimi është mbështetur kryesisht në këto metoda: metodën e analizës, metodën doktrinare (përshkruese) dhe metodën krahasimore. Në përfundim të këtij punimi është nxjerrë konkludimi që legjislacioni pozitiv në Kosovë i kushton një rëndësi të veçantë rregullimit të marrëdhënieve familjare në përgjithësi dhe në veçanti procedurës për lidhjen e martesës. Në Ligjin për Familjen i Kosovës në mënyrë të qartë dhe mjaft të detajuar rregullohet instituti i martesës dhe procedura për lidhjen e martesës.

Fjalët kyçe: martesë, procedurë, dispozita ligjore, ligj

MIRËNJOHJE/FALENDERIME

Këtë studim ia dedikoj familjes time të cilët më kanë mbështetur në të gjitha sferat vazhdimisht dhe më kanë përkrahur në përmbushjen e studimeve të mia, të cilëve do të ju jam mirënjohëse gjatë gjithë jetës.

Falenderim i veçantë shkon për mentoren Prof.Dr. Egzona Osmanaj për kontributin e dhënë në çdo kohë dhe pa përtesë në finalizimin e punimit tim të diplomës si në aspektin profesional ashtu edhe në atë shkencorë,

Gjithashtu falenderoj edhe pedagogët e tjerë të Kolegjit UBT për kontributin e tyre gjatë programit të studimeve.

Poashtu, falenderoj familjen time të gjerë të cilët në mënyra të ndryshme e lehtësuan punën time.

Falenderoj miqtë e mi për mbështetjen që më kanë dhënë në çdo çast.

Faleminderit të gjithëve !

PËRMBAJTJA

| | |
|---|-------------------------------------|
| 1. HYRJE | 6 |
| 2. SHQYRTIMI I LITERATURES | 7 |
| 2.1. Instituti i martesës sipas të drejtës romake | 7 |
| 2.2. Instituti i martesës sipas të drejtës së shariatit | 8 |
| 2.3. Kuptimi bashkëkohor i institutit të martesës | 10 |
| 2.3.1. Kushtet për lidhjen e martesës | Error! Bookmark not defined. |
| 2.4. Organi kompetent për lidhjen e martesës..... | 6 |
| 2.4.1. Vendi i lidhjes së martesës..... | 7 |
| 2.4.2. Procedura për lidhjen e martesës religjioze | 14 |
| 2.4.3. Martesa konzulare..... | 14 |
| 2.5. Të drejtat dhe detyrat e bashkëshortëve..... | 14 |
| 2.5.1. Të drejtat dhe detyrat pasurore të bashkëshortëve..... | 15 |
| 2.5.2. Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve | 15 |
| 2.5.3. Administrimi i pasurisë së përbashkët | 16 |
| 2.5.4. Vlerësimi i pasurisë së përbashkët në rast të mosmarrëveshjes..... | 16 |
| 2.5.5. Pasuria e veçantë e bashkëshortëve | 16 |
| 2.6. Të drejtat dhe detyrimet personale të bashkëshortëve | 17 |
| 3. DEKLARIMI I PROBLEMIT..... | 18 |
| 4. METODOLOGJIA..... | 21 |
| 5. KONKLUZA DHE REKOMANDIME..... | 22 |
| 6. REFERENCAT..... | 23 |

1 HYRJE

Në Kosovë dihet që në periudha të ndryshme martesë është bërë vetëm me pëlqimet e prindërve të martuarve, pa u pyetur fare personat të cilët është dashur të martohen, por ka ndodhur vetëm me pëlqimet e prindërve të tyre, ka patur shkelje të shumta të parimeve themelore të drejtave të njeriut. Me zhvillimin e kohës bashkëkohore kanë ndryshuar edhe qasjet në familje dhe e drejta për martesë respektohet nga të gjithë. Në kohërat e kaluara martesë ka qenë obligative dhe pa të drejtë për ndarje, përveq rasteve të caktuara, apo thënë më drejtë, femrave u janë shkeluar në të shumtën e rasteve të drejtat në martesë, për arsyes se ato duhet të jenë të përmbytura edhe në asnjë rast nuk duhet të ndahen nga burri, pra janë parë më shumë si objekt dhe jo subjekte të së drejtës, mirëpo me avancimin e kohës kanë avancuar edhe të drejtat dhe barazia para ligjit. Më heret në qfardo forme nuk është lejuar apo ka qenë e pamundur iniciativa për divorce, tani është e rregulluara me ligje dhe konventa ndërkombëtare, në martesë nuk duhet ndikuar nga askush pasi që martesë është e shenjtë .

Në këtë punim shqyrtohen dhe analizohen kushtet ligjore dhe procedura për lidhjen e martesës sipas legjislacionit pozitiv në Kosovë. Qëllimi kryesor i këtij punimi është të ofrojë informacione të rëndësishme në lidhje me kushtet për lidhjen dhe vlefshmërinë e martesës, pengesat dhe ndalesat martesore dhe në veçanti për karakteristikat dhe rrjedhën e zhvillimit të procedurës për lidhjen e martesës. Punimi është i ndare në tre kapituj kështu:

Në Kapitullin e parë, trajtohet kuptimi, rëndësia dhe kushtet për lidhjen dhe vlefshmërinë e martesës si dhe pengesat dhe ndalesat martesore.

Në Kapitullin e dytë, trajtohet procedura për lidhjen e martesës sipas legjislacionit pozitiv në Kosovë. Në hyrje të këtij kapitulli trajtohet rëndësia e formes, elementet e procedurës , organi kompetent për lidhjen e martesës. Më pas, në mënyrë më të detajuar flitet për procedurën e lidhjes së martesës veçmas për secilin shtet të përfshirë në studim. .

Në Kapitullin e tretë, shqyrtohen dhe analizohen efektet juridike të martesës gjegjësisht të drejtat dhe detyrimet e bashkësortëve, të drejtat dhe detyrat personale dhe pasurore.

2 SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1 Instituti i martesës sipas të drejtës romake

Në Romën e Lashtë bashkësitë ishin egzogame; meshkujve iu lejohej të martoheshin vetëm me vajza të lindura jashtë rrethit të familjes, ndërsa vajzave, që të martoheshin me meshkuj të grupeve të tjera familjare. Sipas të drejtës romake, martesë mund të lidhnin vetëm personat që ishin në kohën e pubertetit, respektivisht femrat duhet të kishin së paku moshën dymbëdhjetëvjeçare, ndërsa meshkujt duhet të kishin mbushur moshën katërbëdhjetëvjeçare. (*Idrizi, 2018*) “Sipas të drejtës romake martesë është përkufizuar si lidhja midis burrit dhe gruas, që përbën bashkësinë e pandarë të jetës. Me rastin e lidhjes së martesës shtroheshin dy çështje kryesore:

a) Çështja se në cilat kushte vajza mund ta linte familjen e saj dhe të bëhej pjesëtare e familjes së burrit.

b) Çështja se çfarë pozite juridike kishte gruaja në familjen e re. (*Idrizi, 2018*)

Lidhur me çështjen e parë kanë ekzistuar disa zgjidhje. Kështu, në fillim, kërkohej vetëm pëlqimi i kryetarit të familjes, ndërsa më vonë edhe pëlqimi i bashkëshortëve. Sa i përket çështjes së dytë, gruaja pas martesës bëhej person alieni juris, e cila, në mënyrë të ngjashme sikurse edhe personat tjerë në këtë pozitë, u nënshtrohej direkt urdhrave të pater familiasi. (*Idrizi, 2018*) Në kohën e formës fetare të lidhjes së martesës, kushtet për lidhjen e martesës ishin të rënda, por me reformat e bëra ndryshuan edhe kushtet dhe ato bëhen gjithnjë e më të volitshme dhe më të lehta për personat që lidhin martesë. Rëndësi të veçantë i kushtojë lirisë së vullnetit të personave që të lidhin martesë. Në Ligjin Romak, martesë është një status i krijuar nga një marrëveshje e thjeshtë private. Sidoqoftë, sipas mendimit të shumë autorëve, martesë romake, madje edhe e periudhës së fundit, nuk u formua thjesht nga thjesht shkëmbimi i pëlqimeve; ai supozoi një mënyrë jetese të karakterizuar nga akte publike të llojeve të ndryshme. (*Lae, 1907*) Se vullneti i pajtimit nuk ishte i mjaftueshëm, në radhë të parë, e treguar nga fakti, se martesë mund të ndodhë jashtë pranisë së burrit të ardhshëm, duke siguruar që nusja të sillet në shtëpinë e tij; më në fund, dhe mbi të gjitha, ajo nuk mund të ndodhte në mungesë të nuses, pasi në këtë rast ajo nuk mund të jetë në dispozicion të burrit. (*Lae, 1907*) Martesë romake renditet në mesin e kontratave reale; ajo nuk ka ekzistencë, nëse nuk shoqërohet nga një traditio. Pastaj u ngrit në Ligjin Romak, si në të gjitha sistemet e ngjashme, vështirësia: si ta dallojmë martesën nga një bashkim i parregullt, në dy format e tij. Përgjigjja ishte ajo martesë që nënkuptonte qëllimin e burrit për të pasur një grua ligjore, për të ta

rrisë atë në gradën e tij, ta bëjë atë të barabartë, dhe qëllimin përkatës të gruas; kjo u quajt *Affectio Maritalis*. Kështu është shpjeguar në përkufizimin e famshëm romak të martesës, që tregon se gruaja romake ndan gjendjen fetare dhe civile të burrit të saj. (*Lae, 1907*) Kuptimi i klasik i saj ishte ai shprehur nga Modestinos (250 para Krishtit): “Martesa është bashkimi i gruas dhe i burrit, një lidhje e përjetshme dhe komunikim i së drejtës hyjnore dhe njerëzore”. Kjo lidhje daton qysh në kohët më të hershme kur burri dhe gruaja formonin një bashkësi të mirash dhe kultesh. Martesa përmbante në vetvete elementin subjektiv ose qëllimor dhe atë objektiv dhe material, që konkretizohej me bashkëjetesën e burrit dhe të gruas në një bashkim permanent. Kurse elementi subjektiv lidhet me vullnetin e dy palëve që japin konsensusin e tyre për të bërë lidhjen e martesës. (*Bendo, 2009*)

Në shoqërinë romake kanë ekzistuar forma të ndryshme martesash: Forma e parë ishte *coemptio* ose blerja reale e gruas, ku ati i nuses në prani të 5 dëshmitarëve, ia dorëzonte nusen *pater-familias* së dhëndrit, duke marrë një monedhë si simbol të kësaj lidhjeje. *Confreatio* ishte forma e dytë, ajo më solemne që përdorej nga shtresat më të larta të shoqërisë, që kryhej në prani të 10 dëshmitarëve dhe të fejuarit. Dhëndri i jepte nuses kur ajo mbërrinte në derën e shtëpisë, bukë, zjarr dhe ujë, kurse ajo duhej të thoshte “kudo që të jesh ti, do të jem edhe unë” *Usus* që është *formae* tretë dhe më e përhapur në shtresat e varfra të popullsisë dhe që konsistonte në një transferim të thjeshtë të nuses në shtëpinë e burrit. Në të drejtën martesore romake gruaja e vejë nuk mundej të lidhte martesë të re për kohën sa mbante zi për burrin e vdekur, koha e zisë zgjaste dhjetë deri në dymbëdhjet muaj. (*Bilalli, 2015*)

2.2 Instituti i martesës sipas të drejtës së sheriatit

Sipas sheriatit institute i martesës paraqet lidhjen e dy personave me gjini (sekse) të ndryshme, konkretisht midis mashkullit dhe femrës, dhe nuk lejohet midis personave të të njëjtës gjini. (*Halili, 2014*) Sa i përket racës dhe kombësisë së personave që lidhin martesë nuk paraqet pengesë si nëligjet laike po ashtu edhe në të drejtën e Sheriatit, por dallimi ekziston kur është në pyetje religjioni. Në të drejtën laike as religjioni nuk paraqet pengesë për lidhjen e martesës, kjo e drejtë garantohet edhe me deklaratën e përgjithshme për të drejtat e njeriut në të cilën parashihet se “Burrat dhe grate në moshë të pjekur kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të formojnë familje, pa kurrfarë kufizimi për sai përket racës, shtetësisë ose besimit. Në të drejtën e sheriatit kur kemi

të bëjmë me persona që kanë seks tëndryshëm. Një femre myslimane i ndalohet të martohet me jo myslimanin edhe nëse ai është ithtar i Librave të shenjtë (Ungjilli). (Halili, 2014) Martesa (nikah) në Islam është bashkimi i një burri dhe një gruaje. Është një përgjegjësi fetare që duhet të ndërmerren nga ata që janë të gatshëm të jetojnë sipas rregullave që udhëheqin institucionin. Është e qartë nga këto vargje të Kuranit se martesa islame bazohet në nevojën për të arritur dhe ruajtur qetësinë në shoqëri. Kështu familja, e cila vjen në ekzistencë, si rezultat i kësaj martese është themeli themelor i shoqërisë. Megjithëse martesa është e detyruar me forcë dhe celibati është dekurajuar, ata që nuk janë gati të ndërmarrin këtë besëlidhje solemne dhe përgjegjësitë që i bashkëngjiten asaj duhet ta shtyjnë atë.

Martesa shihet si një mjet për kënaqësi emocionale dhe seksuale, si një mekanizëm i reduktimit të tensionit, lindjes së ligjshme dhe vendosjes sociale; si një qasje për aleancën ndërfamiljare dhe solidaritetin e grupit” Sa i përket mashkullit në Islam lejohet që myslimani të martojë hebraiken ose të krishterën, ngase burri është shtylla e shtëpisë, më i fuqishëm se gruaje dhe përgjegjës ndaj saj. Islami garanton besimin e gruas që është ithtare e Librit në martesën me myslimanin dhe i respekton të drejtat e saj në përgjithësi, mirëpo asnjë fe tjetër nuk i garanton të drejtat e gruas që i takon fesë tjetër e as lirinë e besimit të saj, si p.sh. Krishterimi dhe Hebraizmi. (Kardavi, 2002)

Rëndësia e martesës në shoqërinë islame dhe mbrojtja e saj prej mësimëve fetare qëndron në qëllimet e pohuara haptazi të cilave ajo u shërben. Së pari, myslimanët janë të mendimit se martesa si balancë midis kërkesave individuale dhe mirëqenies së grupit, të cilit i përket individ. Si e tillë, ajo quhet si një domosdoshmëri sociale dhe psikologjike për çdo anëtar të komunitetit. Së dyti, martesa është një mekanizëm i kontrollit moral dhe kontrollit reciprocikisht të dobishëm të sjelljes seksuale dhe të lindjes. Qëllimi i tretë, i martesës është parapërgatitja e saj për një atmosferë të qëndrueshme për rritjen e fëmijëve. Së katërti, martesa siguron përfitime ekonomike kryesore (vendimtare) për grat gjatë viteve të mirërritjes së fëmijëve të tyre. Së pesti, bashkëshoqërimi i afërt i partnerëve bashkëshortor siguron kënaqësi emocionale, si për gratë, ashtu edhe për burrat. Nga ky bashkim dashurie, burri dhe gruaje duhet të jetojnë në paqe, të krijojnë dhe të ushqejnë fëmijët që do të vazhdojnë racën njerëzore dhe zhvillimin e shoqërisë. Bashkimi i njeriut dhe gruas së tij gjurmohet në një origjinë të përbashkët të barazisë, sepse të dyja janë krijuar nga një shpirt i vetëm. Disa nga qëllimet e kësaj martese janë:

a) Qëllimi i saj është që burri dhe gruaja të kenë një lidhje të qëndrueshme, por të dy kanë të drejtën të kërkojnë divorcin.

b) Çifti trashëgon njëri nga tjetri.

c) Nënshkruhet një kontratë midis dy palëve. Burri duhet të paguajë për pajën e gruas.

(Bendo, 2009)

Në Islam poligjinia është e lejuar me kusht sipas disa rregullave të përcaktuara qartë. Në teologjinë islamike, të dyja gjinitë janë të barabarta në vlerë dhe ndryshimet midis tyre njihen për shkak të të drejtave, obligimeve dhe roleve të ndryshme. Zakonisht gruaja myslimane është parë si një amvisë dhe rritëse e fëmijëve. Qenia nënë konsiderohet një nga rolet më të rëndësishme në shoqëri. *(Bendo, 2009)*

2.3 Kuptimi bashkëkohor i institutit të martesës

Në Kosovë, institucioni i familjes dhe i martesës, në varësi edhe nga zhvillimi ekonomik shoqëror, ka kaluar historikisht nëpër faza të ndryshme të zhvillimit. Faktor i rëndësishëm ka qenë faktori tradicional. Pa dyshim, se ndikim të padiskutueshëm ka lënë tradita dhe zakonet, qoftë të pashkruara apo edhe të shkruara dhe të përmbledhura, siç mund të jenë rregullat e përmbledhura në Kanunin e Lekë Dukagjinit apo variantet e tjera të tij. Sidoqoftë, rregullat e të drejtës familjare dhe ato të martesës fillojnë të marrin trajtën e rregullimit institucional pas Luftës së Dytë Botërore, kur për herë të parë (përfshirë një periudhë të shkurtër gjatë Luftës së Dytë Botërore, gjatë së cilës, edhe në pjesë të caktuara të territorit të Kosovës gjeti zbatim Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare të vitit 1929), familja dhe martesa rregullohen me ligj, përkatësisht me Ligjin Themelor për Martesën, të datës 13 prill 1946, i cili gjeti zbatim në tërë territorin e ish-RFPJ-së. *(Idrizi, 2018)*

2.3.1. Kushtet për lidhjen e martesës

Martesa lidhet me pëlqim të lirë, përpara nëpunësit të gjendjes civile, mes një burri dhe një gruaje që ka mbushur moshën 18 vjeç. Përfshirë: Gjykata për shkaqe me rëndësi, mund të lejojë martesën përpara arritjes së kësaj moshe. Kërkesa për autorizimin e lidhjes së martesës, bëhet nga vetë i mituri. Konstatohet se “shkaqet me rëndësi”, më të ndeshura në praktikën gjyqësore, në bazë të të cilave, i mituri pretendon lidhjen e martesës përpara moshës së lejuar nga ligji janë: shtatzënia, lindja e një fëmije, bashkëjetesa. I mituri që kërkon autorizimin e lidhjes së martesës duhet të provojë ekzistencën e një shkakut me rëndësi që përllig lidhjen e martesës, ashtu dhe ekzistencën

e një pjekurie fizike e psikike, të domosdoshme për të kuptuar rëndësinë e martesës dhe për të përmbushur detyrimet që rrjedhin prej saj. (*Ligji KFRSH, 2003*)

2.4 Organi kompetent për lidhjen e martesës

Lidhja e martesës fillon me raportin e paraqitur nga ofiqari, duke treguar prezencën e bashkëshortëve të ardhshëm dhe mosekzistimin e pengesave dhe ndalesave martesore të parapara me këtë Ligj. Kjo konstatohet në bazë të dokumenteve të parashtruara dhe deklaratave të bashkëshortëve të ardhshëm, si dhe deklaratave të dëshmitarëve. (*Ligji FK, 2006*) Në rast se ofiqari konstaton mosekzistimin e pengesave dhe ndalesave për lidhjen e martesës, ai i njofton bashkëshortët e ardhshëm mbi dispozitat e këtij Ligji përkitazi me të drejtat dhe detyrimet e tyre edhe gjithashtu ua lexon këto dispozita. Ofiqari duhet t'i pyes bashkëshortët e ardhshëm veç e veç nëse pajtohen të martohen me njeri-tjetrin. Pasi t'i ketë siguruar deklaratat mbi pajtimin për hyrje në martesë, ofiqari e shpall martesën të lidhur. (*Ligji FK, 2006*) Mundësia e njohjes juridike të jetës familjare, e miratuar me ligj, është e vlefshme edhe për martesën. (*Kombe, 2007*)

Nëse martesa lidhet me prokurë, lexohet prokura e dhënë në pajtim me ligjin dhe dispozitave përkatëse. Pasi të konstatojë delegate i kuvendit të komunës, se nuk ka vërejtje në raportin e ofiqarit do ti njoftojë bashkëshortët e ardhshëm me dispozitat e ligjit mbi të drejtat dhe detyrat e tyre që do t'ua lexojn dispozitat e neneve përkatëse të parapara me ligj. (*Selmani, 2012*) Nuk mund të jetë e vlefshme martesa në qoftë se nuk është lidhur përpara organit kompetent, sepse kështu nuk plotësohet kushti thelbësor i saj i parashikuar me ligj – lidhja e martesës përpara nëpunësit të gjendjes civile. Edhe komponenti i dytë – mënyra e parashikuar në ligj është kusht i domosdoshëm për vlefshmërinë e një martese. (*Podvorica, 2010*) Menjëherë pas lidhjes së martesës, bashkëshortëve u jepet çertifikata nga regjistri amë i të kurorëzuarve. Personave të cilët kurorëzohen sipas rregullave fetare nuk mund të bëjnë këtë kurorëzim, derisa bashkëshortët nuk dëshmojnë me çertifikatën nga regjistri amë i të kurorëzuarve se e kanë lidhur martesën. (*Selmani, 2012*) Akti i lidhjes së martesës nënshkruhet nga bashkëshortët, në prani të jo më pak se dy dëshmitarëve. Martesa konsiderohet e lidhur kur zyrtari i gjendjes civile vërteton identitetin e secilit prej bashkëshortëve pasi ka përfunduar procedura e shpalljes së martesës, sipas Ligjit për familjen i Kosovës. (*Ligji GJC, 2011*)

2.4.1 Vendi i lidhjes së martesës

Martesa lidhet publikisht përpara nëpunësit të gjendjes civile, të cilit i është bërë kërkesa për shpallje. (*Ligji KFRSH, 2003*) Lidhja e martesës bëhet në mënyrë solemne në lokalet posaçërisht të caktuara për këtë qëllim. Lidhja e martesës mund të bëhet edhe në lokale tjera, nëse kjo kërkohet nga bashkëshortët e ardhshëm dhe nëse kërkesa e tyre bëhet për shkaqe të arsyeshme. (*Ligji FK, 2006*) Parimi i barazisë sado që është e rregulluar me dispozita ligjore, shprehimisht nuk bën ndonjë diferencim midis grave e burrave, ky parim bëhet shpesh burim shpesh burim i diskriminimit të fshehtë ndaj grave. (*Benedek, 2012*) Për të lidhur martesë është e nevojshme që dy persona të gjinisë së kundërt, në prani të të tjerëve, të shprehin në mënyrë të lirë vullnetin dhe pajtimin e tyre për martesë përpara ofiqarit. Deklarata duhet të jetë e pakushtëzuar dhe e menjëhershme. Palët pjesëmarrëse gjatë lidhjes së martesës janë bashkëshortët, dy dëshmitarë dhe ofiqari. Secili person me aftësi për të vepruar mund të jetë dëshmitar gjatë lidhjes së martesës. (*Ligji FK, 2006*)

Ofiqari është i detyruar të lejojë procedurën për lidhjen e martesës nëse nuk ekzistojnë pengesa dhe ndalesa. Ofiqari është i detyruar të refuzojë bashkëpunimin në procedurën e martesës nëse ekziston ndonjë pengesë apo ndalesë. Ofiqari nuk ka të drejtë të refuzojë bashkëpunimin nëse nuk ekzistojnë pengesa apo ndalesa. (*Ligji FK, 2006*) Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës, nëpunësi i gjendjes civile, pasi bindet për identitetin e bashkëshortëve të ardhshëm, në bazë të akteve dhe të thënieve të dëshmitarëve, si dhe të vete bashkëshortëve të ardhshëm, në prani të dy dëshmitarëve, u lexon bashkëshortëve të ardhshëm nenet e këtij Kodi që përmbajnë të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve, merr nga secili bashkëshort deklarin se ata duan të lidhin martesë dhe, pasi merr pëlqimin e tyre, i shpall në emër të ligjit të martuar. Akti i martesës hartohet menjëherë, nënshkruhet nga bashkëshortët, dëshmitarët dhe nëpunësi i gjendjes civile dhe regjistrohet në regjistrin e martesave. (*Ligji KFRSH, 2003*) Lidhja e martesës shënohet në procesverbal, të mbajtur nga Zyrtari i zyrës së gjendjes civile në komunë, ku pasqyrohet vullneti i përbashkët i bashkëshortëve të ardhshëm, i shprehur në prani të zyrtarit të gjendjes civile, sipas legjislacionit në fuqi. (*Ligji FK, 2006*) Fakti juridik i martesës themelohet dhe vërtetohet me dokumentin që hartohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, e që pasqyron vullnetin e personave, në prani të zyrtarit të gjendjes civile dhe të dy dëshmitarëve. (*Ligji FK, 2006*) Akti i lidhjes së martesës regjistrohet në regjistrin themeltar të lindjes të secilit bashkëshort, kur ata e

kanë regjistrin në të njëjtën zyrë. Kur njëri ose të dytë e kanë regjistrin themeltar në një zyrë tjetër, atëherë zyrtari i gjendjes civile i autorizuar e bën njoftimin tek zyra/zyrat përkatëse për të dhënat që përmban akti i martesës. *(Ligji FK, 2006)*

2.4.2 Procedura për lidhjen e martesës religjioze

LFK përmban rregulla edhe për institutin e martesës fetare gjegjësisht religjioze. Sipas LFK, bashkëshortët të cilët paraprakisht e kanë lidhur martesën zyrtare, mund të lidhin martesë edhe sipas rregullave fetare. Bashkëshortet të cilët paraqiten për lidhjen e martesës fetare duhet të dëshmojnë se paraprakisht e kanë lidhur ate zyrtare. *(Ligji FK, 2006)* Martesa fetare apo religjioze lidhet para zyrtarit të bashkësisë fetare, i cili ka për detyrë që dokumentin për lidhjen e martesës fetare, brenda 5 ditësh nga dita e lidhjes së kësaj martese, t'ia dërgoj ofiqarit ku është lidhur martesa zyrtare. Në bazë të këtij dokumenti, brenda pesë ditësh nga dita e pranimit të këtij dokumenti, ofiqari e regjistron martesën religjioze në librin amzë për të kurorëzuarit dhe e lëshon certifikatën e martesës fetare. *(Ligji FK, 2006)*

2.4.3 Martesa konzulare

Në bazë të fakteve dhe arsyeve të pa shmangshme shtetasit e një shteti mund të lidhin martesën në mënyrë ligjore , në një shtet tjetër, në objektin konzularë, përpara përfaqësuesit të konzulates ose, para përfaqësuesit diplomatik të atij shteti. Që një martesë të arrij të lidhet nga ana e konzullates, kërkohet të plotësohen tre kushte. *(Djurdevic, 2008)*

1) Martesa konzulare mund të lidhet në atë mënyrë , vetëm përpara personave të caktuar juridikisht, për çeshtje të atilla nga ana e konzullatës. Këtë të drejtë ju jepet vetëm nga ministria e punëve të jashtme.

2) Lidhja e martesës nga ana e konzullatës , nuk lejohet që të jetë në kundërshtim me ligjin në atë shtet ku edhe lidhet kjo martesë. Duhet theksuar se këtu duhet të merret që ka përputhshmëri me ligjin , si dhe rregullat e shtetit të huaj , në bazë të akteve të posatëshme ndërkombetare, në bazë të së drejtës dhe ligjit të mbrendshëm të atij shteti , ose, edhe në bazë të përvojës gjyqësore të më të hershme. *(Jaksic, 2008)*

3) Rregull është që këtë të drejtë e kanë vetëm personat të cilët janë shtetas të atij shteti , që i përket konzullata , (në këtë rast, shtetas malazezë), por të cilët gjinden në shtetin e huaj , ku bën pjesë edhe konzulata. Mirëpo nganjëherë mund të kemi edhe raste të atilla , ku kërkohet nga persona jo të një shteti, si psh . burri shtetas malazez ndërsa gruaja shtetase shqiptare, të

ashtuquatjur martesë e përzier . por, nuk mund të lejohet që kjo martesë të lidhet nga ana e konzulates nëse njëri prej bashkëshortëve është shtetas i ati vendi ku ndodhet konzulata. (*Djurdevic, 2008*) Si psh. nuk mund të lejohet lidhja e martesës , së shtetasit malazezë dhe shtetasesë kosovare, në konzullaten malazeze e cila gjendet në Kosovë. Për lidhjen e martesës nga ana e konzulates , nuk është e nevojshme që të kenë leje për vendqendrim në shtetin e huaj.

2.5 Të drejtat dhe detyrat e bashkëshortëve

Më lidhjen e martesës krijohen një tërësi të drejtash dhe detyrimeve reciproke në mes bashkëshorteve. Të drejtat dhe detyrat e bashkëshorteve për nga natyra e tyre ndahen në dy lloje ;të drejtat dhe detyrat personale të bashkëshortëve dhe të drejtat dhe detyrat pasurore të bashkëshortëve. Sipas LFK, të drejtat dhe detyrat e bashkëshorteve janë të rregulluara mbi bazën e parimit të barazisë. Pra, të dy bashkëshortët gëzojnë njëjtë të drejta ,kuptohet është e qartë që krahas të drejtave bashkëshortët mbartin në mënyrë të njëjtë edhe detyrime të caktuara që vijnë si rrjedhojë e lidhjes së martesës.

Në teorinë e së drejtës, të drejtat dhe detyrat e bashkëshortëve ndahen në dy grupe:

- a) Të drejtat dhe detyrat personale të bashkëshortëve;
- b) Të drejtat dhe detyrat pasurore të bashkëshortëve.

Të drejtat dhe detyrat personale të bashkëshortëve ndahen në:

a) Të drejtat dhe detyrat personale për të cilat bashkëshortët nuk mund të bëjnë marrëveshje.

Të drejtat dhe detyrat personale për të cilat bashkëshortët mund të bëjnë marrëveshje . Të drejtat dhe detyrat personale të bashkëshortëve për të cilat bashkëshortët nuk mund të bëjnë marrëveshje- Në grupin e të drejtave dhe detyrave personale për të cilat bashkëshortët nuk mund të bëjnë marrëveshje, bëjnë pjesë: Barazia e bashkëshortëve, besnikëria bashkëshortore, jetesa e përbashkët, pavarësia e tyre për zgjedhjen e punës dhe të profesionit. Bashkëshortet këto te drejta nuk mund t'i rregullojnë ndryshe përveç asaj që ka parashikuar dispozita ligjore (jus cogens). (*Podvorica, 2010*)

Të drejtat dhe detyrat personale të cilat bashkëshortët mund të bëjnë marrëveshje janë: caktimi i mbiemrit, caktimi i vendbanimit , caktimi i shtetësisë, lindja e fëmijeve dhe ekonomia e përbashkët. Të gjitha këto te drejta janë të karakterit dispozitiv, pra bashkëshortet mund t'i rregullojnë me marrëveshje.

2.5.1 Të drejtat dhe detyrat pasurore të bashkëshortëve

Të drejtat dhe detyrat pasurore të bashkëshortëve përbëjnë të ashtuquajturin regjim pasuror martesor. Më regjim pasuror kuptojmë tërësinë e normave juridike që rregullojnë në njërën anë marrëdhëniet pasurore në mes bashkëshortëve dhe në anën tjetër marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve me personat e tjerë. Më reformën e së drejtës familjare gjatë dekadave të fundit, u bënë ndryshime edhe në fushën e regjimeve martesore të cilat kishin si qëllim kryesor vendosjen në një pozitë të barabartë të bashkëshortëve në marrëdhëniet e tyre pasurore. Sot, parimet e të drejtës së regjimeve martesore janë tepër të ngjashme dhe të afërta në legjislacione të ndryshme, duke realizuar harmonizimin nëpërmjet zhvillimit evolutiv shoqëror.

Sipas LFK pasuria e bashkëshortëve rregullohet në dy forma të pasurisë; pasurinë e veçantë të bashkëshortëve dhe pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve.

2.5.2 Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve

Në kuptim të dispozitave të LFK, pasuri e përbashkët e bashkëshortëve konsiderohet pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës, si edhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë. Pasuria e bashkëshortëve e fituar bashkërisht përmes lojërave të fatit konsiderohet gjithashtu pasuri e përbashkët. (*Ligji FK, 2006*) Për të ekzistimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve kërkohet të plotësohen dy kushte: a) Ekzistimi i bashkësisë martesore dhe b) Puna e përbashkët e bashkëshortëve. (*Gashi, M, Rashkaj I, 2011*)

Pasuria e fituar gjatë martesë është pasuria e fituar nga momenti i lidhjes së martesës deri në momentin e ndërprerjes së saj (nëse është e vlefshme ndërprehet me vdekjen e njërit bashkëshort ose me shkurorëzim, nëse është e pavlefshme me anulim). Fakti se ekziston martesë nuk do të thotë se ekziston edhe bashkësia faktike e jetës mes bashkëshortëve. Nëse për një kohë gjatë martesës bashkëshortët nuk jetojnë në bashkësi faktike të jetës, por jetojnë ndaras dhe të pavarur njëri nga tjetri, pasuria e fituar me punë e njërit bashkëshort do të përfaqësojë pasuri të veçantë të tij, nëse në fitimin e saj në asnjë mënyrë nuk ka kontribuar bashkëshorti tjetër. (*Doracaku, 2008*) Përndryshe edhe në rastet kur bashkësia faktike e jetës për një kohë mes bashkëshortëve nuk ekziston, (për shkak të punës, aftësisë profesionale, etj), ashtu që edhe pse ata jetojnë ndaras, bashkëshorti tjetër kujdeset në mënyra të ndryshme për familje dhe në këtë mënyrë kontribuon në fitimin e kësaj pasurie, ajo paraqet pasuri të përbashkët të bashkëshortëve. (*Doracaku, 2008*)

2.5.3 Administrimi i pasurisë së përbashkët

Me pasurinë e përbashkët bashkëshortët administrojnë dhe disponojnë bashkarishtë dhe me marrveshje. *(Ligji FK, 2006)* Mirëpo, bashkëshortët mund edhe të kontraktojnë që administrimi dhe disponimi i pasurisë së përbashkët, në tërësi ose pjesë të saj, të bëhet nga njëri prej tyre. Kontrata mund të kufizohet edhe vetëm në administrim ose vetëm disponim. Kur nuk është kontraktuar ndryshe, administrimi përfshin edhe posedimin në kuadër të aktiviteteve të rregullta. *(Ligji FK, 2006)*

Të drejtat e bashkëshortëve në sendet e paluajtshme të cilat janë pasuri e përbashkët, në regjistrat publik për evidencën e pasurive të paluajtshme, regjistrohen në emër të dy bashkëshortëve, si pasuri e përbashkët e tyre, në pjesë të papërcaktuara. Nëse është regjistruar si pronar i pasurisë së përbashkët vetëm njëri bashkëshort, konsiderohet sikur regjistrimi është bërë në emër të dy bashkëshortëve. *(Ligji FK, 2006)*

2.5.4 Vlerësimi i pasurisë së përbashkët në rast të mosmarrëveshjes

Martesa ka impaktin e vet pasuror e financiar. Asnjë nga bashkëshortet nuk mund që në mënyrë arbitrare të privohet nga pasuria e tij. *(Gashi ,H, Aliu A, 2004)* Nëse nuk arrihet marrëveshja në kohën kur pjesa e secilit prej bashkëshortëve i takon pasurisë së përbashkët, ajo duhet të vendoset nga gjykata. Vendimi duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët. *(Ligji FK, 2006)* Gjykata kompetente vendos po ashtu në rast të mosmarrëveshjes lidhur me pjesët e pasurisë së bashkëshortëve të. *(Ligji FK, 2006)* Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët mund të bëhet si gjatë jetesës së përbashkët martesore, ashtu edhe pas mbarimit të saj. Asnjëri nga bashkëshortët nuk mund që në mënyrë arbitrare të privohet nga pasuria e tij. *(Gashi, Rashkaj, 2011)*

2.5.5 Pasuria e veçantë e bashkëshortëve

Pasuri e veçantë e njërit bashkëshort konsiderohet ajo pasuri të cilën ai e ka pasur para lidhjes së martesës, të cilën ai e ka fituar gjatë martesës, por jo me punë, po me trashëgim, dhurim ose me forma tjera të fitimit pa barrë si dhe pasuria që i takon atij me ndarjen e pasurisë së përbashkët të

bashkëshortëve. Një prodhim arti, punë intelektuale apo pronë intelektuale gjithashtu konsiderohet pasuri e ndarë e bashkëshortit/ës që e ka krijuar. Bashkëshorti në mënyrë të pavarur administron dhe disponon me pasurinë e tij të veçantë, e mund të administrojë dhe disponojë me te edhe përkundër dëshirës së bashkëshortit tjetër. *(Ligji FK, 2006)* Përpos rasteve të mësipërme të fitimit të pasurisë së veçantë, të cilat janë edhe rastet më të shpeshta, në pasurinë e veçantë bëjnë pjesë edhe të gjitha të drejtat sendore dhe ato detyimore të fituara nga pasuria e veçantë, si frutat, qiraja, kamata nga kursimet, etj. Pasuri të veçantë të bashkëshortit përfaqësojnë edhe sendet që shërbejnë për përdorimin e tij personal si sendet e veshmbathjes, stolitë, etj, me kusht që vlera e tyre nuk është joproportionale në krahasim me vlerën e përgjithshme të pasurisë së përbashkët. Së fundi pasuri të veçantë përfaqëson edhe pasuria të cilën e ka fituar njëri bashkëshort gjatë martesës por gjatë kohës kur bashkëshortët kanë jetuar ndaras, nuk ka ekzistuar jeta faktike e përbashkët mes tyre. *(Ligji FK, 2006)*

2.6 Të drejtat dhe detyrimet personale të bashkëshortëve

Bashkëshortët në martesë janë të barabartë, në të gjitha marrëdhëniet personale dhe pronësore. Martesa lidhet për tërë kohëzgjatjen e jetës. Bashkëshortët janë të detyruar të jenë besnik ndaj njëri tjetrit dhe në mënyrë reciproke ta ndihmojnë, respektojnë dhe mbështesin financiarisht njëri tjetrin, posaçërisht në rastet kur njëri prej tyre nuk ka bazë të mjaftueshme materiale për jetesë. Bashkëshortët do të zhvillojnë dhe shprehin ndjenjën e solidaritetit reciprok, si dhe solidaritetin ndaj fëmijëve të tyre të lindur në martesë apo të adoptuar. *(Ligji FK, 2006)* Tërësia e të drejtave dhe detyrime që përfaqësojnë përmbajtjen e marrëdhënies martesore. këto të drejta e detyrime kanë disa veqori speciale që i përmbledhim në vijim: *(Vyshka, 2014)*

- Detyrimet ndërmjet bashkëshortëve janë reciproke (bashkëshortët gëzojnë të njëjtin trajtim juridik);
- Martesa mbështetet në parimin e barazisë morale e juridike;
- Të drejtat e detyrimet rrjedhin ex lege nga data e lidhjes së martesës pa qenë e nevojshme që palët t'i parashikojnë shprehimisht;
- Të drejtat dhe detyrimet martesore nuk mund të shmangen as me marrëveshje bashkëshortore. *(Vyshka, 2014)*

Bashkëshortët duhet të caktojnë mbiemrin e tyre të përbashkët. Me rastin e lidhjes së martesës, bashkëshortët me marrëveshje mund të vendosin: 1. që secili ta mbajë mbiemrin e vet; 2. që i

përbashkët të jetë mbiemri i njërit prej bashkëshortëve; 3. që t'ia bashkëngjis mbiemrin e vet mbiemrit të njërit prej bashkëshortëve. (*Ligji FK, 2006*) Bashkëshortët kanë detyrimin e jetës së përbashkët, një ndër detyrimet në fakt më të rëndësishme sepse kupton kushtëzon dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera. (*Vyshka, 2014*)

Bashkëshortët vendosin për vendin e banimit me marrëveshje. Bashkëshortët vendosin për udhëheqjen e ekonomisë së përbashkët familjare me marrëveshje. Në rast se njëri nga bashkëshortët është përgjegjës për mirëmbajtjen e shtëpisë, ai udhëheq shtëpinë në përgjegjësinë vetanake. Që të dy bashkëshortët kontribuojnë në mirëmbajtjen e familjes në proporcion me aftësitë e tyre individuale. Secili bashkëshort është i pavarur në zgjedhjen e punës dhe profesionit. (*Ligji FK, 2006*) Ekonomia familjare përfshinë të gjithë personat që jetojnë në një banesë të përbashkët dhe që kanë të përbashkëta mjetet kryesore të jetesës. (*Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2011*) Vendbanimi duhet të kuptohet “jo vetëm si një e drejtë për hapësirë fizike, por edhe si një e drejtë për përdorimin në qetësi të plote të kësaj hapësire”

Rregullimi i marrëdhënieve familjare bazohet në parimet: (*Francois, 2007*)

1. Barazinë ndërmjet burrit dhe gruas, respektit dhe ndihmës së ndërsjellët ndërmjet tyre dhe anëtarëve të familjes.
2. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe përgjegjësia e të dy prindërve për rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre, ku fëmijë nënkupton personin nën moshën 18 vjeçare.
3. Prindërit dhe fëmijët detyrohen në ndihmë dhe konsideratë të ndërsjellët gjatë tërë jetës së tyre.
4. Fëmijët e prindërve të cilët nuk kanë qenë të martuar në kohën e lindjes së tyre gëzojnë të drejtat e njëjta dhe kanë detyrime të njëjta si, kurse fëmijët e lindur nga prindërit të cilët kanë qenë të martuar në kohën e lindjes së tyre. (*Francois, 2007*)

Diskriminimi ndaj grave nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e seksit, e që ka për pasojë ose për qëllim të komprometoj ose të asgjësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga gjendja e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër. (*Konventa, 1979*)

3 DEKLARIMI I PROBLEMIT

Në këtë punim u synua të trajtohet dhe analizohet procedura e lidhjes së martesës, në Kosovë. Tema është shtjelluar në një mënyrë me të gjërë se sa është vetëm procedura e lidhjes së martesës, për vet faktin e informimit si dhe të studimit të martesës në përgjithësi.

Martesa paraqet një institut shoqëror dhe juridik për shkak se është formë e organizimit shoqëror dhe rregullohet me rregulla juridike. Rregullat juridike me të cilat rregullohet martesa janë të karakterit të detyrueshëm dhe palët nuk mund t'i ndryshojnë me vullnetin e tyre, prandaj ajo bëhet një institucion juridik i mbrojtur nga shteti. Në Kosovë i kushtohet rëndësi e posaçme rregullimit të marrëdhënieve familjare në përgjithësi dhe në veqanti institutit të martesës. Në Kosovë martesa dhe marrëdhëniet familjare rregullohen më ligj të veçantë, përkatësisht më Ligjin për Familje në Kosovë. Rregullimi i marrëdhënieve familjare-martesore sipas Ligjit për Familje në Kosovë, bëhet duke u bazuar në parimin e barazisë sipas të cilit gruas dhe burrit u garantohen të drejta plotësisht të barabarta.

Në Ligjin për Familje në Kosovë, janë përcaktuar në mënyrë të qartë kushtet për ekzistimin e martesës. Kështu, sipas LFK, kushtet esenciale për themelimin e martesës janë: a) Të ekzistoj pajtimi i vullneteve të tyre për lidhjen e martesës, i shprehur personalisht; b) Martesa mund të lidhet vetëm ndërmjet dy personave të gjinive të ndryshme; c) Forma e caktuar me ligj për lidhjen e martesës, e kjo është që martesa të lidhet para organit kompetent në mënyrë të përcaktuar me ligj. Gjithashtu, në mënyrë të qartë dhe mjaft të detajuar në LFK, rregullohet edhe procedura e lidhjes së martesës. Kështu, sipas rregullave të përmbajtura në LFK, procedura e lidhjes së martesës ligjore shkon kështu:

Së pari, procedura për lidhjen e martesës fillon më parashtrimin e kërkesës nga ana e bashkëshortëve të ardhshëm për lidhjen e martesës. Personat që synojnë të hyjnë në martesë duhet të paraqesin një kërkesë për lidhjen e martesës tek organi kompetent gjegjësisht tek ofiqari komunal. Kërkesës për lidhjen e martesës kërkohet t'i bashkëngjitet çertifikata e lindjes dhe sipas nevojës edhe dokumente të tjera në bazë të kërkesës së ofiqarit, si p.sh., fotokopja e leternjoftimit, fletëpagesa e paguar. Pas pranimit të kërkesës për lidhjen e martesës, ofiqari duhet t'u rekomandojë personave që dëshirojnë të lidhin martesë që deri në datën e lidhjes së martesës, që në mënyrë të ndërsjellët të informohen lidhur me gjendjen e tyre shëndetësore, të vizitojnë konsulentin familjar për të siguruar mendimin profesional përkitazi me zhvillimin e marrëdhënieve harmonike martesore dhe familjare, të njihen me mundësitë dhe përparësitë e planifikimit të familjes, si dhe

të pajtohen lidhur me mbiemrin e ardhshëm. Për të qenë martesë e vlefshme ajo duhet të lidhet në formën e paraparë ligjore. Ligji parasheh të ashtuquajturën formën solemne për lidhjen e martesës. Me ligj nuk është përcaktuar kompetenca tokësore e organit për lidhjen e martesës, ashtu që bashkëshortët kanë të drejtë të pakufizuar të zgjedhjes së vendit ku do të lidhin martesën. Akti solemn i lidhjes së martesës mbahet në lokal të caktuar, por sipas kërkesës së bashkëshortëve e për shkaqe të arsyeshme mund të mbahet edhe në ndonjë vend tjetër. Pjesëmarrës në lidhjen e martesës janë: Bashkëshortët, dy dëshmitar dhe ofiqari. Lidhja e martesës fillon me raportimin e ofiqarit, i cili konstaton prezencën e dy bashkëshortëve të ardhshëm, konstaton se nuk ekzistojnë pengesa dhe ndalesa për lidhjen e martesës. Pas kësaj bashkëshortëve të ardhshëm ofiqari u lexon pjesët e ligjit përkitazi me të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve. Pas kësaj ai i pyet nëse janë të pajtimit të lidhin martesë ndërmjet veti. Pas dhënies së deklaratave identike se pajtohen të lidhin martesë, konstatohet se martesë është lidhur. Ofiqari e regjistron faktin e lidhjes së martesës në regjistrin amzë për të martuarit, në të cilën nënshkruajnë bashkëshortët, dëshmitarët dhe ofiqari. Pas kësaj bashkëshortëve u lëshohet certifikata e kurorëzimit e cila shërben si prove për lidhjen e martesës.

4 METODOLOGJIA

Për realizimin e qëllimit të tij, punimi është mbështetur në metodën e analizës së legjislacionit, metodën doktrinare dhe përshkruese dhe në disa raste edhe në metodën krahasimore. Metoda e analizës së legjislacionit është përdorur për interpretimin e dispozitave ligjore referuar procedurës së lidhjes së martesës. Metoda doktrinare është përdorur për sqarimin e termave dhe koncepteve të ndryshme. Metoda krahasimore është përdorur për të konstatuar ndryshimet apo ngjajshmeritë mbi procedurën e martesës sipas ligjeve përkatëse.

5 KONKLUZA DHE REKOMANDIME

Në punimin e temës “Procedura për Lidhjen e Martesës” u synua që të theksohet fakti se me Ligjin për Familjen i Kosovës në mënyrë të qartë dhe mjaft të detajuar rregullohet instituti i martesës dhe procedura për lidhjen e martesës, ku shihet që legjislacioni pozitiv në Kosovë i kushton një rëndësi të veçantë rregullimit të marrëdhënieve familjare në përgjithësi dhe në veçanti procedurës për lidhjen e martesës. Çdo ditë e më shumë Republika e Kosovës po ecë përpara në integrimet evropiane, e kjo është një dukuri shumë e mirë se ne si shoqëri demokratike megjithatë në të ardhmen do të jemi të përfshirë në mesin e shoqërive të civilizuar të botës. Martesa dhe lidhja e saj është e “shenjtë” për të gjithë, jo vetëm në ditët e sotme, por që nga koha e antikës, mesjetës, kapitalizmit, para dhe pas luftërave botërore dhe deri në ditët e sotme. Një nga fushat të cilat duhet reformuar për të dëshmuar se jemi pjesë e shoqërive të civilizuar është fusha e drejtësisë në përgjithësi e në veçanti përmbajtja e ligjeve dhe akteve tjera juridike që kanë të bëjnë me martesën dhe të drejtën për martesë.

1. Në bazë të analizave duhet vetëdijesuar të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës se martesa mes personave me gjini të njëjtë nuk është objekt rregullimi i Kushtetutës.
2. Lidhja e martesës në Republikën e Kosovës sipas ligjit për familjen-martesën duhet t’i aplikojë dhe të mos i shkelë parimet me elementare bashkëkohore të drejtave të njeriut duke mos pasur diskriminime në bazë të racës, kombësisë, religjionit, barabarësisë së palëve, kohëzgjatjes së martesës dhe zgjidhjes së saj.
3. Republika e Kosovës ka bazë të mirë ligjore sa i përket lidhjes së martesës dhe mund të themi me plotë të drejtë se ligji për familjen i miratuar nga Kuvendi i Kosovës ka rregulluar në mënyrë të qartë dhe precize çështjen e vlefshmërisë së martesës (Shih ligjin për familjen), që parasheh se të gjithë qytetarët e Kosovës kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të krijojnë familje me vullnetin e lirë të tyre dhe duke i respektuar kriteret dhe kushtet që janë të parapara në ligjin për familjen të Kosovës.
4. Bashkëshortët duhet të vendosin që me kontratën e martesës të përcaktojnë mënyrën e shtimit dhe të pakësimit të pasurive gjatë martesës, për të qënë më të qartë në destinacionin e tyre në momentin final.
5. Organizim i ekonomisë duhet të nxit komunikimin transparent midis tyre dhe ndërgjegjëson bashkëshortët edhe për investimin në familje.

6. Objekti i tyre duhet të jetë i ligjshëm dhe në përputhje me rendin juridik, duke bërë kështu këtë akt me fuqi të plotë juridike dhe të zbatueshme për çdo rast, kur është e nevojshme.

6 REFERENCAT

Referencat parësore

- Gashi ,H, Aliu A (2012) E drejta familjare, fq.51, Prishtinë
- Gashi ,H, Aliu A (2012) Komentar Ligji Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, fq.51, Prishtinë
- Podvorica ,H (2011) E drejta familjare, fq.75, Prishtinë
- Djurdjevic ,D (2008) Osnovi porodicnog prava Crne Gore. CID, fq.45, Podgoricë
- Doracak (2015) për përgatitjen e provimit të Jurisprudencës, fq.435, Prishtinë
- Jaksic ,A (2004) Medjunarodno privatno pravo, fq.385, Beograd
- Janjic ,M, Korac R (1996) (1996) Porodicno pravo cetvrto izdanje, fq.109, Beograd
- Jaksic (2008) Medjunarodno Privatno Pravo, fq.385, Beograd
- Bilalli ,A, Bahtiri A (2015) E drejta Romake, fq.17, Prishtinë
- Selmani ,B (2012) E drejta familjare dhe pozita e familjes në shoqërinë bashkëkohore, fq.158, Prishtinë
- Gashi ,M, Rashkaj I (2011) Pasuria e Përbashkët e Bashkëshortëve, fq.79, Prishtinë
- Francois ,J (2007) Detyrimet pozitive sipas Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, fq.44, Strasbourg
- Benedek ,W (2003) Kuptimi i të Drejtave të Njeriut, fq.189, Austri
- Vyshka ,K (2014) Forma e Lidhjes së martesës, fq.3-4, Tiranë
- Idrizi, N. (2018) “Pasojat juridike të shkurorëzimit vështtrim krahasues Kosovë-Shqipëri, fq.9, Prishtinë
- Kardavi, J (2002) Hallalli dhe Harami në Islam, fq.175, Prishtinë
- Bendo, A (2009) Martesa Vlerat e Saj Unikatele dhe Universale, fq.6, Tiranë
- Agjencia e Statistikave të Kosovës, (2011) Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë, fq.9, Prishtinë
- Ligji për familjen i Kosovës Nr. 2004/32 (2006) Neni ,14, Prishtinë
- Ligji Nr. 04/L-003 (2011) për Gjendjen Civile, neni 41-44, Prishtinë
- Ligji Nr.9062 (.2003) Kodi i Familjes, Republikës së Shqipërisë, neni 28, Tiranë

Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (1979) neni 1, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së

Referencat dytësore

<http://njohligjin.al/familja/martesa/>

<https://www.scribd.com/doc/148763878/E-Drejta-Familjare>

<https://studioligjore.wordpress.com/2012/04/20/pasuria-mes-bashkeshorteve-sipas-rregjimit-te-pasuror-ne-bashkesi/>

<http://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=128>